



---

# ANALIZË E PROJEKTLIGJIT PËR REZERVAT E DETYRUESHME TË NAFTËS

---

---

MARS, 2025

**Autor:** INDEP

**Programi:** Zhvillim i Qëndrueshëm

**Publikuar:** Mars, 2025



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

#### **Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



**Rockefeller  
Brothers Fund**  
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	2
Elementet e Draft Ligjit .....	3
Fushëveprimtaria e Ligjit .....	3
Si është paraparë të mbahet rezerva.....	4
Korniza institucionale .....	6
Pagesa dhe mbulueshmëria e saj.....	8
Përfundime.....	10
Rekomandime.....	11

# Hyrje

Kosova, si Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, është e obliguar të zbatojë acquis të BE-së për energjinë, mjedisin dhe klimën. Raporti i zbatimit i vitit 2024 nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vlerëson progresin e Kosovës në përafrimin me këto zotime. Sipas saj “Kosova i nënshtrohet një derogimi nga zbatimi i Rregullores për Sigurinë e Furnizimit dhe Magazinimit të Gazit. Rregullat e sigurisë së furnizimit janë në fuqi. Megjithatë, projektligji për mbajtjen e detyrueshme të stokut të naftës, i parashikuar për miratim në vitin 2023 ose në gjysmën e parë të vitit 2024, mbetet pezull. Nuk ekzistojnë procedura për lirimin e rezervave të naftës emergjente dhe nuk janë raportuar të dhëna për MOS Oil dhe pyetësonin mujor COIR.”<sup>1</sup>

INDEP ka analizuar Projektligjin për Rezervat e Detyrueshme të Naftës të publikuar nga Qeveria e Kosovës në nëntor 2024. Analiza fokusohet në përafrimin e ligjit të propozuar me acquis të Komunitetit të Energjisë, realizueshmërinë e tij për zbatim dhe ndikimin e tij në kornizën e sigurisë energjetike të Kosovës. Duke pasur parasysh mospërputhjen e vazhdueshme të Kosovës me detyrimet e rezervave të naftës, ky propozim legjislativ shënon një hap pozitiv në adresimin e boshllëqeve të kahershme në menaxhimin e rezervave të naftës. Megjithatë, analiza e INDEP vë në dukje fushat kryesore që kërkojnë sqarime dhe përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në lidhje me mekanizmat e zbatimit, përgjegjësitë institucionale dhe detyrimet e raportimit.

INDEP sjell përvojë të gjerë në këtë analizë, pasi ishte OJQ-ja e parë që propozoi një ligj të tillë në vitin 2016 si pjesë e monitorimit të Kuvendit të Kosovës. Nëpërmjet angazhimit aktiv dhe përpjekjeve avokuese, INDEP ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e mbajtjes së naftës si një shtyllë e sigurisë energjetike dhe përputhshmërisë me standardet evropiane. Ky vlerësim bazohet në ekspertizën e viteve dhe në zbatimin e programit të INDEP për Zhvillim të Qëndrueshëm në thelb të së cililit qëndron angazhimi ynë në avokimin për politika energjetike të Kosovës me bazë transparencën, llogaridhënien dhe harmonizimin më të madh rregullator.

---

<sup>1</sup> Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, (2025), 2024 Annual Implementation Report of the Acquis under the Treaty Establishing the Energy Community, Vienna, i qasshëm në <https://www.energy-community.org/documents/secretariat.html> (qasur në shkurt, 2025)

# Elementet e Draft Ligjit

## Fushëveprimtaria e Ligjit

Sipas Projektligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës, këto janë qëllimi dhe fushëveprimtaria e ligjit:

Të sigurojë një nivel të lartë të sigurisë në furnizimin me naftë të papërpunuar dhe produkte të naftës, duke krijuar dhe menaxhuar rezerva minimale të detyrueshme. Rregullon krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të detyrueshme, si dhe ndërhyrjen në rast të çrregullimit të furnizimit.

Ligji zbatohet nga institucionet dhe personat fizikë dhe juridikë që merren me menaxhimin dhe ruajtjen e rezervave të detyrueshme të naftës.<sup>2</sup>

Për të forcuar **Qëllimin dhe Fushëveprimtarinë** e Projektligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës dhe për ta përafuar më shumë me parimet e **Direktivës së Këshillit 2009/119/EC**, rekomandohet përfshirja e dispozitave që theksojnë **besueshmërinë dhe transparencën** në mekanizmat e mbajtjes së rezervave të detyrueshme. Kjo do të sigurojë jo vetëm krijimin dhe menaxhimin e rezervave të naftës, por edhe qeverisjen efektive dhe mbikëqyrjen e tyre.

### Shtesat e propozuara:

#### Tek Qëllimi:

"Ky ligj synon të vendosë mekanizma të besueshëm dhe transparentë për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të detyrueshme të naftës, duke siguruar një nivel të lartë të sigurisë në furnizimin me naftë."

#### Tek Fushëveprimtaria:

"Ky ligj zbatohet nga institucionet, si dhe personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në menaxhimin dhe ruajtjen e rezervave të detyrueshme të naftës, duke siguruar që të gjitha aktivitetet të zhvillohen me besueshmëri dhe transparencë maksimale, në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara."

Këto shtesa do të forcojnë kuadrin e llogaridhënies brenda ligjit dhe do të ndihmojnë në përmirësimin e përputhshmërisë së Kosovës me standardet evropiane për sigurinë energjetike.

---

<sup>2</sup> Qeveria e Kosovës, (2024), Projektligji për Rezervat e Detyrueshme të Naftës, i qasshëm në <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/projektligji-per-rezervat-e-detyrueshme-te-naftes/> (qasur në shkurt, 2025).



## Si është paraparë të mbahet rezerva

Sipas **Projektligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës**, rezervat do të mbahen dhe menaxhohen kështu:

Departamenti përgjegjës ka detyrën për krijimin dhe ruajtjen e rezervave të detyrueshme të naftës për të garantuar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit në Kosovë. Rezervat duhet të mbulojnë të paktën 90 ditë të importeve neto mesatare ditore ose 61 ditë të konsumit të brendshëm mesatar ditor, duke u krijuar gradualisht sipas një plani veprimi të miratuar. Ato ruhen në kapacitete të dedikuara magazinimi, duke siguruar qasje të vazhdueshme dhe të garantuar, në përputhje me kontratat dhe legjislacionin në fuqi, me masa parandaluese për të shmangur çdo pengesë në disponueshmëri. Prioritet mbetet ruajtja e rezervave brenda Kosovës, e përcaktuar në planin e veprimit, ndërsa një pjesë e tyre mund të mbahet jashtë vendit në Shtetet Anëtare të BE-së ose palë nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në bazë të marrëveshjeve bilaterale. Operatorët e magazinimit janë përgjegjës për ruajtjen e cilësisë së rezervave, duke siguruar që ato të përmbushin standardet dhe të jenë të lira nga ndotës apo përbërës të ndaluar. Departamenti menaxhon blerjen, administrimin dhe shitjen e rezervave, duke garantuar një menaxhim efikas dhe të rregullt. Ai gjithashtu inspekton dhe kontrollon që rezervat të jenë gjithmonë të disponueshme dhe fizikisht të qasshme, ndërsa çdo transferim nga objektet e magazinimit kërkon miratim paraprak. Operatorët e magazinimit janë të detyruar të raportojnë tek Departamenti të dhëna specifike mbi rezervat komerciale dhe të detyrueshme, të regjistruara në ditën e fundit të çdo muaji.

### Shtesat e propozuara:

Në përputhje me Direktivën 2009/119/EC, për të siguruar një transpozim të plotë dhe të saktë të saj në legjislacionin e Kosovës, propozojmë disa ndryshime në dispozitat e Projektligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës.

#### 1. Saktësimi i Nivelit të Rezervave

Opsioni i përzgjedhjes midis 90 ditëve të importeve neto ose 61 ditëve të konsumit të brendshëm mesatar duhet të qartësohet në mënyrë që vetëm një prej tyre të përdoret si bazë për përlllogaritjen e rezervave të detyrueshme.

Rekomandim: Të përdoret vetëm 90 ditë e importeve neto mesatare ditore, siç përcaktohet në Direktivën 2009/119/EC, neni 3(1), duke shmangur pasigurinë në zbatim.

#### 2. Përmirësimi i Kërkesave për Ruajtjen e Rezervave

Projektligji duhet të qartësojë që rezervat duhet të jenë të qasshme dhe të menaxhueshme në çdo kohë, duke vendosur një mekanizëm inspektimi që garanton kontrolle periodike.

Rekomandim:

Të përfshihet një dispozitë për detyrimin e operatorëve të magazinimit për të siguruar aftësinë e menjëhershme për lirim të rezervave, në përputhje me nenin 8 të Direktivës 2009/119/EC.

### 3. Prioriteti i Magazinimit të Brendshëm dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare

Projektligji përmend se ruajtja e rezervave në Kosovë ka prioritet, por gjithashtu parashikon ruajtjen jashtë vendit me marrëveshje bilaterale.

Rekomandim:

Të përcaktohen kushte të qarta për përqindjen minimale të rezervave që duhet të ruhen brenda Kosovës.

Të specifikohet se marrëveshjet bilaterale duhet të jenë të nënshkruara përpara transferimit të rezervave jashtë vendit, siç kërkohet nga neni 5(2) i Direktivës 2009/119/EC.

### 4. Cilësia dhe Siguria e Rezervave

Aktualisht, projektligji kërkon që rezervat të mos përmbajnë ndotës apo përbërës të ndaluar, por nuk përcakton standardet teknike që duhet të ndiqen.

Rekomandim:

Të përfshihet referimi tek standardet e cilësisë të përcaktuara nga EN 228 dhe EN 590, që janë kërkesa të legjislacionit të BE-së për cilësinë e karburanteve.

### 5. Raportimi dhe Inspektimi

Projektligji parashikon që operatorët e magazinimit të raportojnë të dhënat mbi rezervat në fund të çdo muaji, por nuk ka një mekanizëm të qartë për monitorimin dhe sanksionet në rast të mosrespektimit të detyrimeve.

Rekomandim:

Të përfshihet një mekanizëm inspektimi të rregullt dhe sanksione për mosrespektimin e kërkesave të raportimit, bazuar në nenin 9 të Direktivës 2009/119/EC.

## Korniza institucionale

Bazuar në Projektligj, më poshtë janë përgjegjësitë e institucioneve që i përfshin:

Institucioni	Përgjegjësia
Ministria	Përgjegjëse për tregun e naftës.
Ministri i Ministrisë	Udhëheq përgjegjës të Ministrisë për rezervat e detyrueshme.
Ministria (Buxheti)	Buxhet i alokuar për krijimin dhe menaxhimin e rezervave të detyrueshme nga Republika e Kosovës.
Ministria (Propozimi i rezervave)	Propozon sasinë dhe përbërjen e rezervave të detyrueshme.
Departamenti	Njësia brenda Ministrisë e autorizuar për menaxhimin dhe shitjen e rezervave të detyrueshme të naftës.
Departamenti (Menaxhimi)	Përgjegjës për krijimin e rezervave të detyrueshme të naftës.
Departamenti (Blerja dhe shitja)	Blen, menaxhon dhe shet rezervat e detyrueshme të Republikës së Kosovës.
Departamenti (Përgjegjësitë teknike)	Përcakton kërkesat teknike për magazinim, propozon kontrata me operatorët e magazinimit, organizon mbushjen e rezervave, siguron sigurinë e stokut të naftës, monitoron pagesat dhe bashkëpunon me agjenci të ndryshme.
Kuvendi i Republikës së Kosovës	Miraton Ligjin për Rezervat e Detyrueshme të Naftës.
Qeveria	Miraton planin e veprimit për krijimin e rezervave të detyrueshme të naftës.
Qeveria (Tarifa për rezervat)	Përcakton normën e tarifës për rezervat.



Qeveria (Masat emergjente)	Vendos masa emergjente në rast të ndërprerjes së furnizimit.
Dogana	Dërgon raporte mujore te Agjencia e Statistikave dhe Departamenti mbi importin, prodhimin, përpunimin dhe eksportin e naftës së papërpunuar dhe produkteve të saj.
Dogana (Tarifa për rezervat)	Llogarit tarifën për rezervat.
Dogana (Raportimi mbi pagesat)	Raporton tek Departamenti për pagesat brenda 15 ditëve të para të muajit vijues.
Agjencia e Statistikave	Merr raporte mujore nga Departamenti me të dhëna të ndara për sasinë dhe llojin e rezervave komerciale, rezervave të detyrueshme të Republikës së Kosovës dhe rezervave të huaja.
Agjencia e Statistikave (Raportimi për Departamentin)	Siguron për Departamentin përmbledhje statistikore mujore mbi importet dhe eksportet.
Agjencia e Statistikave (Raportimi në Eurostat dhe Komunitetin e Energjisë)	Dërgon përmbledhje statistikore te Eurostat dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
Operatorët e Magazinimit (Sektori Privat)	Përgjegjës për ruajtjen e naftës dhe duhet të ketë lejet e duhura për magazinimin e produkteve të naftës.
Operatorët e Magazinimit (Cilësia e rezervave)	Duhet të sigurojnë cilësinë e rezervave të detyrueshme të naftës.
Eurostat dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë	Marrin përmbledhje statistikore nga Agjencia e Statistikave.

Sërish, edhe në këtë nismë ligjore, nafta nuk trajtohet brenda kuadrit të sektorit të energjisë. Kjo vërejtje e INDEP është e kahmotshme. Duke marrë parasysh se nafta është burim energjie strategjik dhe se Zyra e Rregullatorit për Energjinë (ZRRE) ka një mandat të gjerë për mbikëqyrjen

dhe rregullimin e sektorit energjetik, është e nevojshme që ky institucion të përfshihet në zbatimin dhe monitorimin e Ligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës.

ZRRE ka një mandat të qartë për të rregulluar, mbikëqyrur dhe siguruar transparencën në sektorin energjetik, duke përfshirë produktet e naftës dhe derivatet e saj. Ky funksion është i rëndësishëm për të garantuar një treg të qëndrueshëm dhe për të shmangur abuzimet në zinxhirin e furnizimit me naftë. ZRRE tashmë mbledh dhe menaxhon të dhëna të rëndësishme mbi tregun e energjisë, duke përfshirë prodhimin, importin dhe konsumin e produkteve të naftës.

Me një infrastrukturë ekzistuese për raportimin e të dhënave, ZRRE mund të luajë një rol kyç në harmonizimin e statistikave të naftës dhe në raportimin e tyre sipas kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare (p.sh. Eurostat, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë). Ky institucion gjithashtu ka përvojë në mbikëqyrjen e çmimeve të energjisë dhe mekanizmave të tregut, një funksion që mund të zgjerohet për të përfshirë kontrollin e tarifave dhe kostove të magazinimit të rezervave të detyrueshme të naftës. Kjo do të siguronte një treg të ndershëm dhe të rregulluar, duke parandaluar praktikën monopoliste.

Ligji për Rezervat e Detyrueshme të Naftës është një element kyç i politikës së sigurisë energjetike së Kosovës. Si një institucion rregullator i sektorit energjetik, ZRRE ka ekspertizën dhe mekanizmat për të siguruar përputhshmërinë e këtij ligji me legjislacionin ekzistues të energjisë dhe me standardet ndërkombëtare. ZRRE ka përvojë në transpozimin e legjislacionit të BE-së në sektorin e energjisë dhe mund të kontribuojë në sigurimin e përputhshmërisë së këtij ligji me Direktivën 2009/119/EC dhe kuadrin më të gjerë të politikës energjetike të BE-së. Duke marrë parasysh funksionet dhe kapacitetet e ZRRE-së, INDEP rekomandon që ky institucion të përfshihet në ligjin për rezervat e detyrueshme të naftës

### **Pagesa dhe mbulueshmëria e saj**

Sipas Projektligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës, tarifa për rezervat e detyrueshme paguhet nga importuesit dhe prodhuesit e produkteve të naftës kur produkti hidhet në treg ose importohet pa përjashtim nga akciza, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Tarifa nuk zbatohet nëse produkti i naftës nuk përdoret si karburant ose nëse importuesi i ofron Doganës dëshmi të përjashtimit nga akciza. Dogana llogarit tarifën për rezervat e detyrueshme, e cila paguhet në buxhetin e Republikës së Kosovës në të njëjtën kohë me detyrimet doganore. Dogana duhet të raportojë pagesat tek Departamenti brenda pesëmbëdhjetë ditëve të para të muajit vijues, me shumën e llogarituar bazuar në volumin e karburantit në temperaturën 15°C.

Qeveria cakton normën e tarifës çdo vit bazuar në vlerësimin e Departamentit mbi fondet e nevojshme për zbatimin e programit vjetor të punës. Tarifa shprehet në euro për litër ose kilogram të çdo produkti, në përputhje me njësitë e përdorura nga Administrata Doganore. Norma përcaktohet të paktën pesëmbëdhjetë ditë para fillimit të vitit kalendarik, dhe vendimi hyn në fuqi tridhjetë ditë pas miratimit. Mund të bëhen rregullime të normës në bazë të shpenzimeve. Ministria rregullon kërkesat për raportimin e pagesës së tarifës për rezervat e detyrueshme përmes një akti nënligjor.

Një zyrtar i autorizuar mbikëqyr pagesën e tarifës, ndërsa importuesit dhe prodhuesit janë të detyruar të bashkëpunojnë plotësisht, duke mundësuar qasje të lirë në hapësirat e magazinimit, dokumentacionin, sistemet elektronike dhe çdo të dhënë të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë. Një gjobë prej 1,000 eurosh vendoset për çdo pagesë të tarifës që nuk ofron, vonon ose dorëzon informacione të pasakta ose të paplota sipas kërkesës.

Sipas Projektligjit për Rezervat e Detyrueshme të Naftës, tarifa për rezervat e detyrueshme paguhet nga importuesit dhe prodhuesit e produkteve të naftës kur produkti hidhet në treg ose importohet pa përjashtim nga akciza. Megjithatë, duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm të kësaj tarife në rritjen e çmimeve të karburanteve dhe efektet e saj në grupet më të cenueshme të shoqërisë, është e rëndësishme që ligji të përfshijë një mekanizëm për vlerësimin e ndikimit të tarifës në varfërinë energjetike dhe konsumatorët e cenueshëm.

**Shtesat e propozuara:**

**Rekomandohet që në ligj të përfshihet një dispozitë e posaçme që detyron një vlerësim periodik të ndikimit të tarifës në konsumatorët e cenueshëm, duke marrë parasysh faktorët si:**

**Rritja e mundshme e çmimeve të karburanteve dhe ndikimi i saj në shpenzimet për ngrohje dhe transport për familjet me të ardhura të ulëta.**

**Përcaktimi i kritereve të qarta për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm, në përputhje me programin kombëtar për konsumatorët e cenueshëm.**

**Identifikimi i masave kompensuese apo mbështetëse për grupet e prekura nga rritja e kostove të karburantit si rezultat i tarifës.**

**Ndikimi në kostot e transportit publik dhe mallrave esenciale, duke vlerësuar se si kjo mund të rrisë shpenzimet për familjet në nevojë.**

## Përfundime

Projektligji për Rezervat e Detyrueshme të Naftës paraqet një hap të rëndësishëm drejt përmbushjes së detyrimeve të Kosovës ndaj Komunitetit të Energjisë dhe harmonizimit me acquis të BE-së. Ky ligj synon të rregullojë krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të detyrueshme të naftës, duke ofruar një mekanizëm më të strukturuar për garantimin e sigurisë së furnizimit me naftë në vend. Megjithatë, analiza e INDEP ka identifikuar disa boshllëqe dhe çështje të cilat kërkojnë adresim të mëtejshëm për të siguruar një transpozim të plotë dhe efikas të Direktivës 2009/119/EC, si dhe për të garantuar një sistem më të qëndrueshëm dhe transparent të menaxhimit të rezervave të naftës në Kosovë.

Edhe pse projektligji përmban dispozita të rëndësishme për krijimin dhe administrimin e rezervave të detyrueshme të naftës, disa aspekte të tij mbeten të paqarta ose të paplotësuara në përputhje me kërkesat e Direktivës 2009/119/EC. Kjo përfshin qartësimin e bazës së llogaritjes së rezervave, mekanizmat e mbikëqyrjes dhe inspektimit, si dhe transparencën në menaxhimin e rezervave. Nafta nuk trajtohet si një burim strategjik brenda sektorit të energjisë, duke lënë jashtë rregullimit një institucion kyç si ZRRE. Kjo mungesë kufizon kapacitetet mbikëqyrëse dhe harmonizimin me rregullat ekzistuese të tregut energjetik në Kosovë.

Projektligji përcakton që rezervat të mbahen kryesisht brenda Kosovës, me mundësinë e ruajtjes jashtë vendit përmes marrëveshjeve bilaterale. Megjithatë, ai nuk përcakton kriteret e qarta për përqindjen minimale të rezervave që duhet të ruhen në Kosovë, si dhe nuk vendos kushte specifike për marrëveshjet ndërkombëtare para transferimit të rezervave jashtë vendit.

Projektligji nuk përcakton standarde teknike të detajuara për cilësinë e rezervave të naftës, duke lënë hapësirë për paqartësi dhe rreziqe të mundshme për sigurinë e furnizimit. Mungesa e referimit në standardet e BE-së (EN 228 dhe EN 590) për cilësinë e karburanteve mund të ndikojë në sigurinë dhe përdorshmërinë e rezervave. Edhe pse projektligji përcakton që operatorët e magazinimit duhet të raportojnë të dhënat mbi rezervat çdo muaj, ai nuk përfshin një mekanizëm të qartë për monitorimin e rregullt dhe masat sanksionuese në rast të mosrespektimit të detyrimeve.

Projektligji nuk përmban një dispozitë specifike për të vlerësuar ndikimin e tarifës së rezervave në konsumatorët e cenueshëm, duke rrezikuar përkeqësimin e varfërisë energjetike dhe rritjen e çmimeve të karburanteve për grupet më të ndjeshme socio-ekonomikisht.

## Rekomandime

- Projektligji duhet të përcaktojë qartë se baza për përlogaritjen e rezervave të detyrueshme duhet të jetë 90 ditë e importeve neto mesatare ditore, siç kërkohet nga Direktiva 2009/119/EC, duke shmangur opsionin e dyfishtë me 61 ditë të konsumit të brendshëm. Të përfshihen mekanizma të rregullt inspektimi dhe të garantohet që rezervat e detyrueshme të jenë gjithmonë të qasshme dhe të menaxhueshme në çdo kohë, duke respektuar nenin 8 të Direktivës.
- ZRRE duhet të përfshihet si një institucion mbikëqyrës dhe rregullator për zbatimin e këtij ligji, duke marrë përgjegjësinë për monitorimin e tregut, inspektimin e çmimeve dhe transparencën në menaxhimin e rezervave të naftës. Roli i ZRRE-së duhet të përfshihet si një mekanizëm shtesë për të garantuar stabilitetin dhe konkurrencën në tregun e karburanteve.
- Të specifikohet një përqindje minimale e rezervave që duhet të ruhen brenda territorit të Kosovës sipas njërit ose tjetrit standard të Direktivës, jo sipas të dyjave. Të vendosen dispozita ligjore që specifikojnë qartësisht kriteret kur lejohet dërgimi i rezervës sipas marrëveshjeve ndërkombëtare jashtë shtetit.
- Projektligji duhet të referojë EN 228 dhe EN 590 si standarde të cilësisë së karburanteve, duke siguruar që rezervat të jenë të përshtatshme për përdorim dhe të përputhen me kërkesat e BE-së.
- Të përfshihet një mekanizëm i rregullt i inspektimit për operatorët e magazinimit dhe një sistem i qartë për sanksionet në rast të mosrespektimit të detyrimeve të raportimit. Të përcaktohet një strukturë e qartë për monitorimin e rezervave nga një autoritet përgjegjës, duke siguruar mbikëqyrjen periodike dhe reagimin e shpejtë ndaj shkeljeve.
- Ligji duhet të përfshijë një dispozitë për vlerësimin periodik të ndikimit të tarifës në konsumatorët e cenueshëm. Të përcaktohen kriteret e qarta për mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm dhe të identifikohen masa mbështetëse për grupet e prekura. Të vlerësohet ndikimi i tarifës në çmimet e transportit publik dhe mallrave esenciale, për të shmangur përkeqësimin e kushteve ekonomike për familjet me të ardhura të ulëta.

**Ky punim u botua me mbështetjen e Fondit të vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti përfshirë opinionet e shprehura, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të INDEP-it, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo bordit.**

**Mbështetur nga:**



**Zbatuar nga:**

